



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 10.7.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, NË KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI I PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”, në mbledhjen e datës 10 korrik 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Rehabilitimi dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore me Rinasin synon modernizimin e saj nëpërmjet përmirësimit të karakteristikave gjeometrike dhe operationale të linjës hekurudhore në përputhje me standardet e BE-së, të përcaktuara nga direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e transportit hekurudhor të mallrave e të udhëtarëve ndërmjet Tiranës, Durrësit dhe aeroportit të Rinasit dhe, në të njëjtën kohë, për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik të zonës ekonomike të rajonit të Durrësit, Tiranës dhe të gjithë vendit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë transportin hekurudhor ndërmjet Durrësit dhe Tiranës, duke përmirësuar infrastrukturën dhe operationet hekurudhore, garantuar sigurinë e lëvizjes dhe ndërveprimin, ndërtimin e një lidhje të re hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit, si dhe ndërfutja e një regjimi miqësor me mjedisin, nëpërmjet zvogëlimit të bllokimeve të trafikut rrugor ndërmjet Durrësit, Tiranës dhe aeroportit të Rinasit dhe kontributit në reduktimin e ndotjes së ajrit nga trafiku rrugor në rajonin Durrës - Tiranë.

Marrëveshja synon dhënien, qeverisë shqiptare, nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të një granti prej 35 435 000 eurosh, i cili do të përdoret për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.

Kostoja totale e projektit është rreth 90.45 milionë euro dhe është financuar pjesërisht nga një hua e akorduar nga BERZH-i rreth 36.87 milionë euro; një pjesë nga një grant i akorduar nga BERZH-i si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të ndryshme nën Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor rreth 1.215 milionë euro; qeveria shqiptare për shpronësime dhe mbulim TVSH-je rreth 16.06 milionë euro; ndërsa Granti i Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor që paraqitet për miratim me këtë projektligj, në vlerë 35.435 milionë euro do të plotësojë financimin e mbetur pa mbuluar për projektin, duke synuar bashkëfinancimin deri në 50 për qind të kostove kapitale të tij, financimin e mbikëqyrjes së punimeve, si dhe mbështetjen për zbatimin e projektit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Ilir NDRAXHI

Relator

Eduard SHALSI

Kryetar